



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.104/02-30415/25
Kaçanik, 16.01.2026

PROCESVERBAL- Takimi Publik me qytetar : Puna e Kryetarit të arriturat dhe sfidat gjatë vitit 2025

Data:19.12.2025

Vendi: Salla e vogël e Komunës

Ora: 14:00

Në takim prezantoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut Sabedin Vishi dhe stafi ekzekutiv. Kryetari Sabedin Vishi: përshëndes qytetarët dhe përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatrave, duke i uruar ata me rastin e festave të fundvitit.

Prezantoi aktivitetet komunale në secilin sektor gjatë vitit 2025, duke i atribuar sukseset edhe Kryetarit të deritashëm Besim Ilazi.

Ka vazhduar realizimi i projekteve komunale në të gjithë sektorët nga buxheti komunal. Në shërbimet publike kanë vazhduar punimet në rrugë, trotuare, kanalizim, e ujësjellës, në zhvillim të turizmit janë realizuar projektet rekreative në Shtrazë, në projektin e shkallëve të Guri i Shpum, ndërtimi i shtegut të lirisë, si dhe investime në Kompleksin Memorial të Varrezat e Dëshmorëve, në bujqësi kemi shumëfishuar shumën e premtuar për subvencione të fermerëve me mjete pune, investime kemi bërë edhe në shëndetësi, me rregullimin e infrastrukturës shëndetësore, me mirëmbajtjen e objekteve dhe aparaturës së QKMF-së, pajisjen me mamografi, ndërsa kemi përkrahur edhe familjet sociale, ku 36 familje janë bërë me kulm mbi kokë.

Investime janë bërë edhe në infrastrukturën arsimore me rregullim të sallave të edukatës fizike, renovim të objekteve shkollore, digjitalizim të shkollave, ndërsa është rritur numri i studentëve që kanë përfituar bursa nga komuna.

Në debat morën pjesë edhe disa qytetarë të cilët kanë pësuar së fundi nga djegia e banesës fqinje, të cilët kërkuar ndihmë për pastrimin e pjesëve të dëmtuara nga zjarri. Kryetari Vishi bëri të ditur se ka zhvilluar takim edhe me familjen që ka pësuar nga djegia e banesës ku edhe i është ofruar ndihmë brenda mundësive komunale, ndërsa ndihmë dhe përkrahje u ofroi edhe banorëve të tjerë të cilët kanë pësuar nga kjo djegie, e cila fatmirësisht ka përfunduar vetëm me dëme materiale e pa pasoja në njerëz.

Të pranishmit në debat, qytetarë e administrator të lagjeve dhe fshatrave uruan kryetarin e ri të sapo zgjedhur, ndërsa përgëzuan komunën për punët dhe arritjet komunale, duke paraqitur edhe kërkesat e lokaliteteve që ata përfaqësojnë.

Nuhi Berisha- e dimë se janë marrë mjetet e projekteve nga qeveria për të paguar borgjet ndaj arsimtarëve, andaj edhe jemi të kënaqur aq sa keni pasur mundësi për të investuar. Kam shqetësimin tim që shumë qytetar po lakmojnë me dal jashtë Kaçanikut, andaj kërkoj që të gjendet një mundësi që që mos të zbrazen zonat malore. Poashtu kërkoj të bëhet sërish spitali i mushkërive, ndërsa të kisha të shqyrtohen hapësira për parkingje, si dhe të zgjidhet problemi i mbeturinave inerte tek një hapësirë te guri i shpum.

Shaban Horuni- Kërkoj që në fshatin Biqec të rregullohet rruga alternative, rruga “ Sokaki i Fushës” të zgjerohet, e poashtu kërkoj që të zgjerohet, rregullohet dhe të bëhet edhe një park dhe parking te rruga e hyrjes së shkollës, si dhe kërkoj rregullim të rrugës te varrezat.

Fatmir Luta: Rruga kryesore dhe te shkolla në Gajre kanë probleme me ujë.

Ziber Luma- Për fshatin Gllaboqicë kemi potencuar kërkesat tona edhe në takimet e më hershme, kemi nevojë për zgjerim të kanalizimit të ujërave të zeza, zgjerim të rrugës Rreze Dielli dhe rregullim të kanalizimit të kësaj rruge e rregullim të rrugicave. Kryetari Sabedin Vishi- Përmes projekteve si rregullim të rrugëve lokale e projekteve për ndërtimin e kanalizimeve fekale e atmosferike, do të ndërhyhet varësisht se ku do të paraqitet nevoja për të vepruar.

Takimi përfundoi në ora 15:10 min.

Procesmbajtëse:

Fatlume Guri Selimi

